



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



**DREJTORIA E PËRGJITHSHME
E PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

BASHKIA SHKODËR

Nr. 1000 Prot., datë 05.03.2025

Nr. Prot., datë 21.3.2025
6457

MARRËVESHJE BASHKËPUNIMI

NDËRMJET:

**DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE
(DPPI)**

DHE

BASHKISË SHKODËR

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi lidhet ndërmjet:

DREJTORISË SË PËRGJITHSHME TË PRONËSISË INDUSTRIALE

e njohur më poshtë si “**DPPI**”

DPPI është institucioni i vetëm përgjegjës për regjistrimin, administrimin dhe promovimin e të drejtave të Pronësisë Industriale në Republikën e Shqipërisë, detyrim që i buron nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, nga ligji organik nr.9947, datë 07.07.2008 “Për Pronësinë Industriale” i ndryshuar, neni 189, si dhe nga dokumente strategjike si: Marrëveshja e Asociim-Stabilizimit në nenin 73 të saj, “Pronësia Intelektuale”.

DPPI funksionon në formën e një agjencie autonome, nën mbikëqyrjen e ministrit përgjegjës për ekonominë, pranë ministrisë së Ekonomisë, Kulturës dhe Inovacionit (MEKI).

Adresa e institucionit është: Bulevardi “Zhan D’Ark”, Ish - Shtëpia e Ushtarakëve, Prona Nr. 33, Tiranë, Shqipëri, përfaqësuar nga titullari:

Znj. Maria Solis – Drejtor i Përgjithshëm i Komanduar,

DHE

BASHKISË SHKODËR

e njohur më poshtë si:

Njësi e Vetëqeverisjes Vendore, person juridik publik, krijuar sipas Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe që organizohet e funksionon sipas ligjit organik nr.139/2015“Për vetëqeverisjen vendore”, i ndryshuar;

Adresa e institucionit është: Rruga 13 Dhjetori, Nd. 9, H 1, Shkodër, 4001, Shqipëri përfaqësuar nga titullari:

Z.Benet Beci- Kryetar i Bashkisë Shkodër

Neni 1

Rëndësia e Bashkëpunimit

Duke patur parasysh se:

1. Pronësia Intelektuale është një shtyllë e rëndësishme për ngritjen dhe zhvillimin e një veprimtarie të qëndrueshme ekonomiko-sociale dhe kulturore të një vendi;
2. Ekziston një nevojë bashkëpunimi ndërinstitucional me qëllim mbrojtjen e pronësisë intelektuale;
3. Palët janë të interesuara të promovojnë dhe të përmbushin objektivat e përgjithshme për mbrojtjen e pronësisë intelektuale, që angazhohen në këto veprimtari;
4. Palët shprehin dakordësinë mbi rëndësinë e ndërgjegjësimit publik mbi pronësinë intelektuale dhe përçimin e saj.

Palët bien dakord të nënshkruajnë këtë Marrëveshje Bashkëpunimi, sipas modaliteteve të mëposhtme:

Neni 2

Qëllimi i Bashkëpunimit

Fokusi i kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi, kryesisht do të jetë në përfshirjen në aktivitete të përbashkëta, panairë, me qëllim sensibilizimin e subjekteve tregtare në bashkinë e qytetit të Shkodrës.

Neni 3

Objektivat e Marrëveshjes

1. Organizimin e aktiviteteve të përbashkëta, me qëllim mbrojtjen dhe regjistrimin e objekteve të pronës industriale, për bizneset e qytetit të Shkodrës;
2. Organizimit e tryezave të rrumbullakta të përbashkëta dhe sesione bisedimesh, mbi mbrojtjen dhe regjistrimin e pronës industriale;
3. Shkëmbimin e ndërsjellë të informacionit mbi fushën e pronësisë industriale, nga Palët, kur ato e shohin të arësyeshme.

Neni 4

Modalitetet e Bashkëpunimit

1. Secila Palë do të caktojë një koordinator të Marrëveshjes, përgjegjës për zbatimin e saj; konkretisht nga pala e DPPI-së, do të jetë Drejtoria e Koordinimit, Promovimit dhe Trajnimeve.
2. Ngritja e një grupi të përbashkët pune, për konkretizimin e bashkëpunimit me veprimtari të ndryshme;
3. Organizimin dhe vënien në dispozicion për publikun e gjerë, të informacionit dhe rezultateve të çdo veprimtarie të përbashkët;
4. Grupet e përbashkëta, do të përpunojnë mënyrat dhe veprimet e përbashkëta, për përmbushjen e qëllimit të kësaj Marrëveshjeje Bashkëpunimi.

Neni 5

Afati i Marrëveshjes

5.1 Kjo marrëveshje, lidhet për një afat të pacaktuar. Përmbajtja e kësaj marrëveshjeje, mund të ndryshojë me pëlqimin me shkrim të të dyja palëve.

5.2 Kjo marrëveshje, mund të shfuqizohet me kërkesën e njëres palë, pas njoftimit paraprak me shkrim, të paktën 30 (tridhjetë) ditë përpara, që parashton edhe arsytet e prishjes së kësaj marrëveshjeje.

Neni 6

Nënshkrimi dhe Hyrja në fuqi

Kjo Marrëveshje Bashkëpunimi nënshkruhet në gjuhën shqipe, në 4 (katër) kopje origjinale me vlerë të njëjtë, dy për secilën palë dhe hyn në fuqi në momentin e nënshkrimit nga të dyja palët.

PALËT:

PËR:

DREJTORINË E PËRGJITHSHME

TË PRONËSISË INDUSTRIALE

(DPPI)

DREJTOR I PËRGJITHSHËM I KOMANDUAR

ZNJ. MARIA SOLIS



PËR:

BASHKINË SHKODËR

KRYETAR

Z. BENET BECI

